

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Ilace dhe materiale mjekesore per vitin 2024.

I ndare me lote si me poshte:

- 1- **Loti nr 1.** Objekti: Blerje Ilace me **Fond limit** 1 178 124 leke pa Tvsh.
- 2- **Loti nr 2.** Objekti: Blerje materiale mjekesore me **Fond limit** 312 880 leke pa Tvsh.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 33140000-3.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Shendetesore Klos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Jane parashikuar ne kriteret e pergjithshme.

##### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit qe prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 Germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.2** Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar te gjitha detyrimet te maturuara te taksave dhe tarifave vendore te vitit 2023, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e këtij prokurimi me vlerë totale jo më të vogël se 40% e fondit limit:

a) Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, të shoqëruara me fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësua sipas legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

**2.3.2.** Afati i skadencës së medikamenteve të jete mbi 1 (një) vit nga momenti i sjelljes në Qendren Shëndetësore dhe brenda stadarteve mjekësore të përcaktuara nga MSH. (Deklarate).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 6, nenin 40, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Me anë të këtij kriteri Autoriteti kontraktor vërteton që malli objekt prokurimi është sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

### **2.3.3. License për tregtim me medikamente.**

**Argumentimi:** Në bazë të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licensimin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

### **2.3.3. License për tregtim me materiale mjekësore.**

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licensimin perkates sipas legjislacionit ne fuqi.

## NJËSIA E PROKURIMIT